



**BASHKIA HIMARË**

Nr. Prot: 81

Himarë, më 29.08.2016

**KONTRATË SIPËRMARRJE**

E lidhur sot më datë 29.08.2016, midis palëve:

Autoritetit Kontraktor: **Bashkia Himare, (në cilësinë e investitorit)** përfaqësuar nga **Kryetar Z.Jorgo Goro.**

dhe

Kontraktorit **TEA-D shpk, (në cilësinë e sipërmarrësit)** përfaqësuar nga **Z.Dintar Thanasi,** Përfaqësues ligjor, me adrese: Lagja Nr.18 Shtatori, Gjirokaster.

Kontraktori merr persiper te kryeje punimet e kontrates "**Rikualifikim Urban Sheshi Borsh**", ne vleren **26.133.333 (njetzet e gjashte milion e njeqind e tridhjet e tre mije e treqind e tridhjete e tre) lekë me TVSH.** Autoriteti Kontraktor ka pranuar oferten e Kontraktorit ne tenderin e zhvilluar ne Bashkine Himare, me date **15.08.2016** per kryerjen dhe perfundimin e ketyre punimeve si dhe riparimin e çdo difekti.

Prandaj me anen e kesaj kontrate palet bien dakord si me poshte:

**Neni 1: Baza ligjore**

1.1 Kjo Kontrate bazohet ne nenin 850 e vijues te Kodit Civil, Ligjin nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik", me te gjitha ndryshimet, si dhe ne VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik".

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK (kushtet e përgjithshme të kontratës) me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 PK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.

1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Objekti i kontrates**

2.1 Do te perbeje objekt te kesaj Kontrate kryerja e punimeve per kontrates "**Rikualifikim Urban Sheshi Borsh**".

- 2.2 Kryerja e punimeve ndertimore objekt i kesaj kontrate do te jete e bazuar në çmimet e njesise te Shprehura ne Preventivin ne njesi.
- 2.3 Afati i realizimit te punimeve, objekt i kesaj kontrate do te jete **180 dite** nga data e fillimit te punimeve, sipas grafikut te punimeve, mbështetur në nenin 19 të kësaj Kontrate.
- 2.4 Ne kete kontrate, termat e perdorura do te kene kuptim te njejte sic percaktohet ne kushtet e kontrates ne dokumentat standarte te tenderit, te cilave do t'ju referohemi tani e tutje, dhe do te konsiderohen pjese perberese e kesaj kontrate.

### **Neni 3: Përkufizime**

- 3.1 **"Preventiv total"** do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 3.2 **"Preventiv per njesi"** do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 3.3 **"Afati i realizimit te punimeve"** do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga Autoriteti Kontraktor.
- 3.4 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 3.5 **"Cmim kontrate"** do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 3.6 **"Realizimi i punimeve"** do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 3.7 **"Defekt"** do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 3.8 **"Data e hyrjes"** do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 3.9 **"Data e fillimit"** eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, "data e fillimit" do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 3.10 **"Pajisje"** do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 3.11 **"Materiale"** do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 3.12 **"Objekt i kontratës"** do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 3.13 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 3.14 **"Drejtues projekti"** do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 3.15 **"Autoritet Kontraktor"** do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakton punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.
- 3.16 **"Kantier"** do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 3.17 **"Raport i inspektimit të kantierit"** do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 3.18 **"Nënkontraktues"** do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 3.19 **"Kontraktor"** do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

- 3.20 **"Standarte Teknike"** do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 3.21 **"Ngritja e kantierit"** do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 3.22 **"Punime"** do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

#### **Neni 4: Hartimi i Kontratës**

- 4.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 4.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

#### **Neni 5: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 5.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përsëritura në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 5.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 5.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 6: Informacioni Konfidencial**

- 6.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 6.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 6.1 më sipër.

#### **Neni 7: Prona Intelektuale**

- 7.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 7.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 7.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

- 7.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 8: Origjina e Materialeve**

- 8.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 8.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 8.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 8.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 9: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 9.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 9.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonje nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 10: Komunikimi**

- 10.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 11: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët**

- 11.1 Kontraktori duhet të bashkepunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 12: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

#### **Neni 13: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 13.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 13.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

#### **Neni 14: Kontraktori që Kryen Punimet**



- 14.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 14.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 14.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 15: Ekzekutimi i Punimeve**

15.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontrates sipas përcaktimeve të bera në nenin 19 të kësaj kontrate dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda afatit të mbarimit të përcaktuar në këtë kontratë.

#### **Neni 16: Ngritja e Kantierit**

- 16.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 16.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Drejtuesi i Projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

#### **Neni 17: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 17.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 17.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

#### **Neni 18: Zbulimet**

18.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

#### **Neni 19: Disponimi i Kantierit**

19.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit brenda 5 ditëve nga lidhja e kontrates. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. **Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë proces-verbal për datën e hyrjes.**

#### **Neni 20: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

20.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

20.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

#### **Neni 21: Paralajmërimi në Kohë**

21.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë Drejtuesin e Projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

#### **Neni 22: Kontrolli i Cilësisë**

22.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

22.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

22.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

22.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

#### **Neni 23: Defektet e Pakorrigjuara**

23.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospëmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 24: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor**

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

#### **Neni 25: Përgjegjësitë e Kontraktorit**

25.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 24.

#### **Neni 26: Sigurimi**

- 26.1 Kontraktori duhet te siguroje objektin, me emra te perbashket te Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit, nga data e hyrjes ne kantier deri ne Afatin e Realizimit te Plote, ne shumate e shprehura ne KVK per humbje ose demtim Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose demtim te kantierit ose pronave te tjera ne kantier dhe demtimet personale ose vdekjet e paleve te treta.
- 26.2 Polica e sigurimit do te dorezohet tek drejtuesi i projektit per aprovim brenda 30 diteve pas shpalljes se fituesit te kontrates. Ky siguracion duhet te mbuloje kompensimin e kerkuar per te kompensuar humbjen ose demin e shkaktuar. Nese kontraktori deshton te siguroje policen e sigurimit, kontrata do te konsiderohet e anuluar. Megjithate Autoriteti Kontraktor, mund te vendose te zgjase periudhen e paraqitjes te polices se sigurimit ose te beje vete siguracionin dhe te zbresin koston e tij nga pagesa qe i jep kontraktorit .
- 26.3 Kushtet e siguracionit nuk mund te ndryshohen pa aprovimin paraprak te Autoritetit Kontraktor.

### **Neni 27: Testimet dhe Inspektimet**

- 27.1 Kontraktori duhet te beje te gjitha testet dhe inspektimet e kerkuara nga dispozitat e kontrates. Kosto e ketyre testeve dhe inspektimeve duhet te financohet teresisht nga kontraktori brenda cmimit te kontrates.
- 27.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka te drejte te ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nese materialet prodhohen ose pregatiten ne vende te ndryshme nga ato te kontraktorit, kontraktori duhet te siguroje leje per Autoritetin Kontraktor per te ndjekur keto teste dhe inspektime.
- 27.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund ti kerkoje kontraktorit te beje teste ose inspektime shites te paparashikuara ne kontrate por te gjykuara te nevojshme per te verifikuar se Punimet jane konform specifikimeve dhe kushteve te kontrates. Autoriteti Kontraktor do te mbaje pergjegjesi per koston e ketyre testeve. Gjithashtu, nese keto teste ndalojne progresin e punes se kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do te bjerë dakort te ndryshoje grafikun.
- 27.4 Autoriteti Kontraktor do te refuzojë çdo Punim qe nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve te kerkuara ne zbatimin e kontrates.
- 27.5 As egzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontrates.
- 27.6 Inspektimet dhe testimet para vertetimit te mbarimit te Punëve do te përfshijne: **Inspektimin dhe testimin gjate gjithë kryerjes se investimit duhet te behen per te gjitha zerat qe kryhen konform Specifikimeve teknike te paraqitura.**

### **Neni 28: Garancitë**

- 28.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.
- 28.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.
- 28.3 Periudha e garancise per punimet eshte **12 muaj** nga dita e lëshimit të çertifikatës së përkohshme të marrjes ne dorezim te punimeve.

### **Neni 29: Çmimi i Kontratës**

- 29.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.
- 29.2 Çmimi për realizimin e punimeve ndertimore objekt i kësaj kontrate do të jetë:
- **Vlera totale e kontratës pa TVSH është: 21.777.777** (njetzet e një milion e shtateqind e shtatedhjet e shtate mije e shtateqind e shtatedhjet e shtate) lekë;
  - **Vlera totale e kontratës me TVSH është 26.133.333** (njetzet e gjashtë milion e njëqind e tridhjet e tre mije e treqind e tridhjet e tre) lekë;
  - **TVSH është në vlerën prej 4.355.555** (kater milion e treqind e pesedhjet e pese mije e pese qind e pesedhjet e pese) lekë.
- 29.3 Çmimi i kontrates do të paguhet në monedhen Leke Shqiptare .
- 29.4 Lloji i Kontrates do të çmohet si një Kontrate me çmim njesie të bazuar në çmimet e njesise të shprehura në preventivin i cili është situacioni përfundimtar.

### **Neni 30: Kushtet e Pagesës**

- 30.1 Çmimi i kontratës, ku nuk përfshihen edhe pagesat pjesore, duhet të paguhet siç specifikohet në kontratë.
- 30.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.
- 30.3 Pagesa për situacionin përfundimtar do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së situacionit pjesor.
- 30.4 Pagesa për Punët Përfundimtare do të bëhen brenda 30 ditëve nga data e leshimit të certifikates së perkohshme të marrjes në dorëzim të punimeve nga Grupi i marrjes në dorëzim të punimeve.
- 30.5 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë Punimet e egzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet të paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit për përfundimin e punimeve.
- 30.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

### **Neni 31: Vonesa në Bërjen e Pagesës**

- 31.1 Shpërblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.
- 31.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (kontraktori) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar një dem më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

### **Neni 32: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

- 32.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

### **Neni 33: Forca Madhore**





- 33.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.
- 33.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 33.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.
- 33.4 Kontraktuesi do të përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve, dhe nuk do të quhet se është në mospërmbushje në lidhje me kontratën për aq kohë, dhe në atë masë, sa zgjat pamundësia për të përmbushur detyrimet si dhe afati për përmbushjen e detyrimeve të prekura nga Forca madhore do të shtyhet automatikisht për aq sa do të zgjasë Rasti i Forcës Madhore.
- 33.5 "**Forcë Madhore**" do të thotë çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është apsolutisht tej parashikimit dhe kontrollit, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të palës së cënuar (Pala e Cënuar) që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të palës së Cënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:
- a) Kjo rrethanë, në mënyrë objektive dhe absolute, nuk mund të parandalohet apo nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohet nga Pala e Cënuar ;
  - b) Pala e Cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në aftësinë e Palës së Cënuar, për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj, në mënyrë që të shmange pasojën e këtij rasti.
  - c) Rasti nuk është ose nuk ka qënë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, dhe
  - d) Pala e Cënuar i jep njoftim Palës tjetër (Pala e Cënuar) në afatin e rënë dakord.
- 33.6 "**Rastet e Forces Madhore**" përfshijnë situatat, ngjarjet apo rrethanat e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to, me kusht që ato të plotësojnë kriteret e shprehura në përkufizimin më sipër të Forcës Madhore :
- a) Aktet e Zotit;
  - b) Veprimet e luftës, pushtimi ose akti i një armiku të jashtëm, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot;
  - c) Aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat e natyrës politike, aktet ose fushatat e terrorizimit;
  - d) Rrufeja, zjarri, tërmeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore;
  - e) Epidemitë ose murtaja; dhe
  - f) Çdo akt sabotimi, grevat ose veprimtaritë e punës për të imponuar ose për të ngadalësuar punën (sidohet duke përjashtuar punonjësit e Palës që e pretendon atë si rast të Forcës Madhore ose punonjësit e ndonjërit prej ortakëve /aksionerëve të kësaj Pale, ose punonjësit e ndonjë filiali të kontrolluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga shoqëria meme ose degë e ndonjë ortakut/aksionari të kësaj Pale si dhe Përfaqësuesve, agjentëve, furnizuesve, nënkontraktorëve të Palës në fjalë).

**Neni 34: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

*OK*

*[Signature]*

- 34.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 34.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.
- 34.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likujdueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 34.4 Në pamundësi të zbritjes së shumës sipas paragrafit më sipër, Autoriteti Kontraktues do ta zbresë shumën në fjalë nga shuma e sigurimit të kontratës, përcaktuar në nenin 44. paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 34.5 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore me aq sa ka zgjatur Forca Madhore.
- 34.6 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.
- 34.7 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë, të zhdëmtohet nga Kontraktuesi për moszbatim apo jo në përputhje me kontratën.
- 34.8 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve që duhet paguar, sipas paragrafit më sipër, nga çdo shumë pagese që duhet të kryejë sipas kontratës në favor të Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 34.9 Në pamundësi të zbritjes së shumës sipas paragrafit më sipër, Autoriteti Kontraktues do ta zbresë shumën në fjalë nga shuma e sigurimit të kontratës, përcaktuar në nenin 44.
- 34.10 Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë, por jo detyrim, që para se të kërkojë shpërblimin e dëmit të kërkojë përmbushjen në natyrë të detyrimeve sipas kontratës.
- 34.11 Për të shmangur çdo paqartësi, përmbushja në natyrë sipas nenit më sipër, përjashton të drejtën e Autoritetit Kontraktues për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

### **Neni 35: Pagimi i dëmeve**

35.1 Dëmet ditore të pagueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve, për moskryerjen, në përputhje me kontratën, do të llogariten me tarifën e si më poshtë:

35.2 Afati i realizimit të punimeve është **30 dite** sipas grafikut të punimeve.

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Nëse lind dëmi për vonesat në mbarimin e punimeve shuma e llogaritur sipas shkronjes a do të mbahet Kontraktorit nga pagesa e Situacionit përfundimtar, dhe nëse kjo nuk mjafton atëherë shuma do të mbahet nga pagesa e garancisë së Kontratës.
- c) Shumat e dëmeve sipas paragrafëve më sipër. Në rast se nuk paguhet nga Kontraktuesi vullnetarisht brenda 7 (shtatë) ditëve nga njoftimi, do të mbahen nga shuma e sigurimit, përcaktuar në nenin 44.

**Neni 36: Negociatat dhe Amendamentet**

- 36.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.
- 36.2 Asnjë amendament ose ndryshim tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa u bërë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoriteti Kontraktor.
- 36.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, fuqitë/tagrat ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 37: Ndryshimi i Porosisë**

- 37.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.
- 37.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës. Për punimet shtesë duhet të respektohet procedura e Ligjit të Prokurimit Publik.
- 37.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:
- Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
  - Korrigjime në materiale
  - Korrigjime në sasi
- 37.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.
- 37.5 Ndryshimi i porosisë nuk do të jete i vlefshëm nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 36 te percaktuar me siper.

**Neni 38: Preventivi per Njesi ose ne Total**

- 38.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv per Njesi pasi është një kontratë me çmim njesie. Meqenese është një kontratë me çmim njesie, Preventivi per Njesi do të përmbajë volumet e zerave te ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.
- 38.2 reventivi per Njesi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në Preventivin ne Njesi për secilin ze punimesh.

**Neni 39: Mbarimi dhe Marrja Përsipër e Ndertimeve**

- 39.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.
- 39.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

- 39.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

#### **Neni 40: Zgjidhja për mospërmbushje**

40.1 Autoriteti Kontraktor mund të zgjidhe kontratën në tërësi ose pjesërisht, duke ruajtur të drejtën për shpërbimin e dëmit, nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për zgjidhjen për mospërmbushje dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mospërmbushjen me përjashtim të rastit/eve kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin zgjidhja do të jetë e menjëhershme.

40.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfunduara do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata zgjidhet për mosplotësim të kushteve të saj.

#### **Neni 4: Zgjidhja për Shkak të Falimentimit**

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të zgjidhe kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për zgjidhjen.

#### **Neni 42: Zgjidhja për Shkak të Interesit Publik**

42.1 Autoriteti Kontraktor mund të zgjidhë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

42.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për zgjidhjen.

42.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara zgjidhjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeseshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

#### **Neni 43: Transferimi i të Drejtave**

43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 44: Sigurimi i Kontrates**

44.1 Me marrjen e njoftimit për fitimin e kontratës, kontraktori i dorëzoi Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën (prej 10% të vlerës së ofertës) është **2.613.333** (dy milion e gjashtëqind e trembedhjetë mijë e treqind e tridhjetë tre) lekë dhe formën e pranueshme siç specifikohet në dokumentat e tenderit.

44.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

44.3 Kontraktuesi është i detyruar, sa herë që shumën e sigurimit të Kontratës ulet si rrjedhojë e mbulimit apo pagimit të dëmeve apo çdo shume a dëmshpërblimi tjetër sipas kësaj kontrate, ta plotësojë atë deri në nivelin para kryerjes së pagesave apo mbulimeve të tilla.

44.4 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së lëshimit të Çertifikatës së përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, 5 (pesë) përqind e depozitës

12

(50% e vlerës së sigurimit të kontratës) do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë që është 12 muaj nga lëshimi i certifikatës së përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeve pas së cilës do të lëshohet certifikata përfundimtare.

#### **Neni 45: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

- 45.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.
- 45.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 46: Përfaqësimi i Palëve**

- 46.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 46.2 Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Himare** cakton mbikqyres punimesh **Ing.Elca Tafilaj**, punonjese e kesaj Bashkie, me licenc mbikqyrje unimesh M.1211, e cila do te jete pergjegjese ne emer te pales për mbikqyrjen e marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 46.3 Kontraktori do te perfaqesohet nga **Dintar Thanasi**, i cili do te jete pergjegjes ne emer te pales, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 46.4 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 46.5 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit

#### **Neni 47: Lajmërimet**

- 47.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 47.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

#### **Neni 48: Llogaritja e Afateve**

- 48.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike .

#### **Neni 49: Dispozita te fundit**

- 49.1 Kjo kontrate hartohet ne 5 (pesë) kopje nga te cilat nje kopje per Kontraktorin dhe kater kopje për Autoritetin Kontraktor, te cilat pasi lexohen, siglohet ne çdo faqe dhe firmoset e vulozet ne faqen e fundit nga te dyja palet.

**Bashkia Himare**

**Jorgo GORO**

**Kryetar**



**TEA-D shpk**

